



**UNIVERSITETI - AAB**  
**ARENA E ARSIMIT BASHKËKOHOR**  
**PRISHTINË**

---

# **RREGULLORE**

# **PËR PROCEDURËN DISIPLINORE**

Prishtinë, 2006



# UNIVERSITETI - AAB

## ARENA E ARSIMIT BASHKËKOHOR

### PRISHTINË

Në bazë të nenit 33 alineja 17 dhe 18, nenit 63 dhe 64 të Statutit të Universitetit AAB, Bordi i Universitetit nxori dhe miratoi rregulloren e mëposhtme:

#### I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

##### Neni 1.

Me anën e kësaj Rregulloreje synohet të rregullohet:

- Procedura disiplinore për personelin akademik dhe administrativ të Universitetit AAB (në tekstin e mëtejme: Universiteti) dhe studentëve të këtij Universiteti;
- Paraqitja dhe identifikimi i shkeljeve të bëra;
- Shkeljet disiplinore;
- Emërimi i komisionit disiplinor;
- Masat në lidhje me shkeljet disiplinore dhe çështje tjera;
- Përcaktimi i përgjegjësisë disiplinore të studentëve të Universitetit AAB dhe
- Procedura e ankesave, e drejta për ankesë, emërimi i komisionit për ankesa.

#### II. PROCEDURA DISIPLINORE PËR PERSONELIN E UNIVERSITETIT

##### Neni 2.

##### 1. Paraqitja dhe identifikimi i shkeljes disiplinore

- a) Çdo shkelje e dyshuar ose e supozuar e personelit akademik të angazhuar më punë në Universitet duhet të paraqitet të **Rektori i Universitetit**;
- b) Shkeljet e bëra nga ana e mësimeve paraqiten tek udhëheqësi i departamentit përkatës respektivisht **Dekani i fakultetit përkatës**;
- c) Shkeljet disiplinore të personelit administrativ paraqiten të udhëheqësi i administratës respektivisht tek **Sekretari i Universitetit**.

##### Neni 3.

Organet e cekura në nenin 2, (në tekstin e mëtejme: Organet e Universitetit) menjëherë pas pranimit të raportit me gojë apo me shkrim për shkelje të supozuar disiplinore, duhet të bëjnë hetimin e rastit, të intervistojnë shkelësin e supozuar dhe personin që ka raportuar, të analizojnë deklaratat e dhëna, dhe sipas vlerësimit të tyre të vendosin për natyrën e shkeljes (e lehtë apo e rëndë).



## UNIVERSITETI - AAB ARENA E ARSIMIT BASHKËKOHOR PRISHTINË

Me rastin e marrjes së vendimit, Organet e Universitetit duhet të mbështeten në dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 4.

### 2. Shkeljet disiplinore

#### a) Shkelje e lehtë disiplinore konsiderohet:

Mungesa e paarsyeshme nga puna, mosrespektimi i orarit të punës, gabimet e vogla të pakujdesshme ose gabimet e përsëritura që nuk do të jenë temë për inicimin e procedurës disiplinore, do të merren si shkelje e lehtë disiplinore.

Organet e Universitetit do të mbledhin dhe rishqyrtojnë çdo dokument ose evidencë që ka lidhje me rastin, do të marrin në pyetje shkelësin e supozuar, deklaratën e tij, personin që ka paraqitur rastin e supozuar dhe secilin që ka informata në lidhje me rastin.

Intervistimi duhet të mbahet sa më shpejt që është e mundur.

Neni 5.

Nëse Organi i Universitetit përfundon se është bërë shkelje e lehtë dhe është për herë të parë, mjafton një **paralajmërim verbal**, kurse për shkelje të përsëritur mund të **paralajmërohet me shkrim**.

Procesverbali i paralajmërimit me gojë dhe me shkrim vendoset në dosjen personale të personit.

Neni 6.

Në rastin kur si rezultat të shkeljes disiplinore kemi dhunën ndaj njerëzve të tjerë ose rrezik ndaj pronës, Organi i Universitetit mund të vendosë ta suspendojë (pezullojë) shkelësin e supozuar nga puna për kohën derisa hetimet dhe procedura disiplinore të jenë duke u zhvilluar.

Neni 7.

Si shkelje disiplinore serioze – e rëndë konsiderohen:

- Kundërshtimi i paarsyeshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara në kontratën e punës;
- Vjedhja, mashtrimi, falsifikimi, dëmtimi ose shfrytëzimi i paautorizuar i pasurisë së Universitetit;



## UNIVERSITETI - AAB ARENA E ARSIMIT BASHKËKOHOR PRISHTINË

- Shkelja e dispozitave të Kodit të Mirësjelljes;
- Mungesa e paarsyeshme në punë më shumë se 3 ditë radhazi dhe pa e lajmërua mungesën;
- Gabimet e përsëritura të cilat e çrregullojnë ecurinë normale të punës;
- Diskriminimi ose keqtrajtimi i drejtpërdrejt ose jo i drejtpërdrejt, kundër personit tjetër të Universitetit, në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, religjionit, banimit, mendimeve politike, origjinës sociale, dhe rasteve tjera të mbrojtura me ligj;
- Ngacmimi verbal i personit tjetër, e karakterizuar si sjellje fizike ose verbale e natyrës seksuale, shkelja e dinjitetit të personit në punë që është e padëshirueshme ose fyese e cila krijon armiqësi, duke kërcënuar ose frikësuar atë person;
- Sjellja e keqe jashtë vendit të punës që nuk përkon me statusin e personelit ose studentit në Universitet, dhe e cila mund të ndikojë në diskreditimin e Universitetit;
- Dëmtimi i pronës me paramendim;
- Zbulimi i fshehtësisë afariste;
- Përdorimi i alkoolit ose drogës gjatë orarit të punës dhe sjellja e vetës në paaftësi serioze si rezultat i përdorimit të tyre;
- Dhënia e deklaratës së rrejshme në lidhje me konfliktin e interesit;
- Sjellje agresive, kërcënuese ose fyese në vendin e punës etj.

Neni 8.

### b) Përcaktimi i shkeljes së rëndë disiplinore

Nëse Organi i Universitetit përfundon se është kryer shkelje e rëndë, ai rastin do t'ia paraqesë Komisionit Disiplinor.

Organi i Universitetit do ta intervistojë shkelësin e supozuar brenda 5 ditësh prej që është referuar te Komisioni Disiplinor dhe do të sqarojë:

- Natyrën e shkeljes së supozuar;
- Që shkelja e supozuar të trajtohet si serioze;
- Kur dhe ku do të mbahet seanca e Komisionit Disiplinor;
- Që ai mund të shoqërohet në seancë nga një i punësuar tjetër;
- Propozimin për masën që duhet shqiptuar.

Neni 9.

### 3. Komisioni Disiplinor

- Organet e Universitetit mund të formojnë një Komision Disiplinor i cili do të vendosë për rastet që kanë të bëjnë me shkeljet serioze të supozuara;



## UNIVERSITETI - AAB ARENA E ARSIMIT BASHKËKOHOR PRISHTINË

- Për rastet nga pika a) e nenit 2, Komisioni gjithmonë përbëhet nga Rektori dhe dy anëtarë tjerë nga departamenti përkatës;
- Për rastet nga pika b) e nenit 2, Komisioni përbëhet nga udhëheqësi i departamentit përkatës, Rektori dhe një anëtar tjetër sipas departamentit përkatës;
- Për rastet nga pika c) e nenit 2, Komisioni përbëhet nga Sekretari i Universitetit, Rektori i Universitetit dhe një anëtar nga administrata;
- Rektori është anëtar i përhershëm i Komisionit Disiplinor.

Rektori i Universitetit mund të themelojë një Komision Disiplinor të veçantë i cili do t'i shqyrtojë rastet e ndryshme, ky komision për nga përbërja mund të jetë i ndryshëm nga ai i paraparë në nenin paraparak.

### Neni 10.

Seanca disiplinore duhet të mbahet dhe vendimi duhet të jepet në një afat kohor sa më të shkurtër të mundshëm.

Komisioni Disiplinor shqyrton dëshmitë, dhe në bazë të të dhënave përcakton nëse shkelja është kryer dhe, në fund nëse ekziston shkelja, shqipton masën disiplinore përkatëse.

Vendimi i Komisionit Disiplinor duhet të vendoset në dosjen e personit.

### Neni 11.

#### 4. Masat për shkeljet e rënda disiplinore

Komisioni Disiplinor pas shqyrtimit të rastit mundë të shqiptojë këto masa:

- vërejtje me gojë,
- vërejtje me shkrim,
- vërejtja e fundit,
- ulja e pozitës,
- ndëshkimet financiare dhe
- ndërprerja e marrëdhënies së punës.

Masat disiplinore të parashikuara në alinenë 1 dhe 2 të këtij neni shqiptohen nga Organet e Universitetit të parapara në nenin 2, ndërsa masat disiplinore nga alineja 3-5 shqiptohen nga Komisioni Disiplinor.

### III. PËCAKTIMI I PËRGJEGJËSISË DISIPLINORE TË STUDENTËVE

#### Neni 12.

Studentët janë të detyruar t'u përmbahen obligimeve që dalin nga aktet e përgjithshme të Universitetit dhe nga kjo Rregullore.

Studentët duhet me kujdes ta shfrytëzojnë pasurinë që u është ofruar për shfrytëzim gjatë studimeve, ta ruajnë nga shkatërrimi – prishja.



## UNIVERSITETI - AAB ARENA E ARSIMIT BASHKËKOHOR PRISHTINË

Për cenimin e rregullave ligjore të Universitetit, studenti mund të përgjigjet për shkelje disiplinore.

### Neni 13.

#### 1. Shkelja e lehtë disiplinore

Si shkelje e lehtë disiplinore konsiderohen:

- sjelljet jo korrekte në objektet punuese të Universitetit;
- Prishja e rendit dhe qetësisë gjatë ligjëratave duke penguar punën normale të mësimeve dhe studentëve;
- Dëmtimi dhe shkatërrimi i pajimeve mësimore, laboratorëve, kompjuterëve, fondit librar në biblioteka, dhe pasurisë tjetër në Universitet;
- Kryerja e aktiviteteve tjera me të cilat dëmtohet dhe cenohet autoriteti i Universitetit, mësimeve, bashkëpunësve, punësorëve tjerë dhe studentëve të Universitetit.

### Neni 14.

#### 2. Shkelja e rëndë disiplinore

Si shkelje të rënda disiplinore konsiderohen:

- Falsifikimi, përmirësimi i të dhënave në Indeks, Certifikatë, Vërtetim dhe dokumente tjera që lëshohen nga Universiteti AAB;
- Falsifikimi i notës apo nënshkrimit të mësimeve;
- Dhënia e shënimeve jo të sakta organeve të Universitetit, për qëllime të caktuara;
- Paraqitja në provim në emër dhe llogari të studentit tjetër;
- Shkatërrim me paramendim i pasurisë së Universitetit;
- Mosrespektimi i mësimeve dhe urdhrave të tij, ofendimi dhe veprime tjera që pengojnë procesin mësimor;
- Përdorimi i alkoolit dhe mjeteve tjera të ndaluar në lokalet e Universitetit;
- Cenimi i integritetit fizik i të tjerëve;
- Kryerja e veprimeve tjera që janë në kundërshtim me rendin shtëpiak dhe rregullat e Universitetit;

### Neni 15.

Procedura disiplinore për studentë nuk mund të fillohet pas kalimit të afatit tre mujor nga dita e marrjes në dijeni për shkeljen e bërë për rastet e shkeljeve të lehta disiplinore.



# UNIVERSITETI - AAB

## ARENA E ARSIMIT BASHKËKOHOR

### PRISHTINË

Ndërsa për rastet e shkeljeve të rënda afati është 6 muaj.

Neni 16.

### 3. Marrja e masave në lidhje me shkeljen disiplinore

Organet e Universitetit pas hetimit dhe shqyrtimit të hollësishëm të rastit mundë të marrin këto masa:

- vërejtja me gojë,
- vërejtje me shkrim,
- para-përgjashtim,
- përjashtim nga Fakulteti për 6 muaj,
- përjashtim nga Fakulteti për një vjet,
- përjashtim nga Fakulteti për dy vjet,
- përjashtim përgjithmonë nga Fakulteti,
- Universiteti mund të shqiptojë edhe ndonjë masë tjetër që nuk parashihet më lart por që kontribuon në disiplinimin e studentit.

Në raste urgjente, për arsye të ndryshme, Komisioni Disiplinor mund të shqiptojë masa disiplinore deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Masat e parapara në pikën 1 dhe 2 të këtij neni mundë të shqiptohen nga udhëheqësi i departamentit përkatës – Dekani i fakultetit përkatës, ndërsa masat prej pikës 3 deri 7 i shqipton Komisioni Disiplinor.

## IV. PROCEDURA E ANKESËS

Neni 17.

a) Procedura e ankesës ka për qëllim mbrojtjen e personit dhe studentin nga vendimet e padrejta.

b) Personi i pakënaqur me Vendimin e Organit të Universitetit me të cilin i është shqiptuar masa disiplinore ka të drejtë ankese. Ankesa i drejtohet organit të shkallës së dytë, gjegjësisht Rektorit të Universitetit.

c) Personi i pakënaqur me Vendimin e Komisionit Disiplinor me të cilin i është shqiptuar masa disiplinore ka të drejtë ankese. Ankesa i drejtohet Sekretarit për Bordin e Universitetit.

d) Ky i fundit mund të formojë një Këshill për Shqyrtimin e Ankesave për rastet kur vet është shqiptues i masës disiplinore.

Neni 18.

Paraqitësi i ankesës duhet të paraqet fakte, argumente dhe prova të reja duke përmbledhur shkurtimisht arsyet për ankesë.

Seanca për shqyrtimin e ankesave duhet të mbahet sa më shpejt që është e mundur dhe për çdo rast jo më vonë se 30 ditë nga dita kur ankesa i është drejtuar Organit të Universitetit.



## UNIVERSITETI - AAB ARENA E ARSIMIT BASHKËKOHOR PRISHTINË

---

Organi i Universitetit kryen këto veprime:

- Rishqyrton dëshmitë e ofruara,
- Në bazë të dëshmimeve të ofruara, përcakton se a duhet të pranohet ankesa,
- Në raste të miratimit të masës së shqiptuar nga Organi i shkallës së parë apo ndryshimit të saj, bënë arsyetimin e të njëjtës.

### V. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 19.

Në rast se dispozitat e kësaj rregulloreje janë në kundërshtim me dispozitat e Statutit të Universitetit, përparësi kanë dispozitat e Statutit.

Neni 20.

Interpretimin e kësaj Rregulloreje e bënë Zyra Juridike e Universitetit në bashkëpunim me Sekretarin e Universitetit.

Neni 21.

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregulloreje mund të bëhet sipas të njëjtës procedurë të miratimit

Neni 22.

Rregullorja hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Këshillit Drejtues.

Prishtinë, 2006

Kryetari i Bordit të Universitetit

---